



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 969/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega Gjakovë paraqitur për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve në komunën e Gjakovës, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega Gjakovë

Arsyetim

PZAP, më datë 01.12.2013 ka pranuar ankesën nga subjekti politik AKR me të cilën pretendohet se me datën 01.12.2013 në komunën e Gjakovës në fshatin Demjan në shkollën Durak Ahmeti në QV 0213C/03R një person me emrin Hajdar Leniqi voton me dokument që nuk është valid e ai ka qene vetem kuponi te cilin e jep komuna kur aplikon për letërnjoftim vetem me emer dhe mbiemër pa foto, ky dokument ka qene i nënshkruar nga menaxheri Sali Cena i ka thene kryesuesit te vendvotimit se dokumenti është valid.

Lidhur me këtë PZAP-i e informoi Policinë e Kosovës për rastin në fjalë dhe kërkoi që ta informoj për këtë rast, por PZAP-i nuk pranoi asnjë informacion nga Policia e Kosovës lidhur me këtë rast.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është pabazuar

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për tu vërtetuar pretendimet e tilla ankimore, PZAP-i konsideron si të

pabazuara dhe te pa argumentuara nga shkakun se nga veprimet e ndërmarra nga PZAP-i në drejtim të vërtetësisë së shkeljes së pretenduar si dhe nga mungesa e ndonjë informacioni nga policia e Kosovës PZAP-i konstaton se me këtë rast nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 969/2013 më datën 04.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.